Probleme të hartimit të fjalorëve terminologjikë

Dr. Gani PLLANA
FIM Prishtinë
E-mail: ganipllana44@hotmail.com

Prof. ass. Sadete PLLANA
FE Prishtinë
E-mail:sadetepllana@outlook.com

Përmbledhje
Lënda e gjerë dhe e pasur nga fushat e terminologjive të ndryshme teknike ka krijuar kushtet për hartimin e fjalorëve terminologjikë qysh nga vitet '50 të shek. XX, ndonëse kjo veprimtari ka fillesa më të hershme. Për hartimin e tyre ka ndikuar drejtpërdrejt zhvillimi i vetë terminologjisë shqipe, si nga ana e lëndës së krijuar, ashtu edhe nga ana e përpunimit të saj dhe e pasqyrimit në fjalorët përkatës. Rruga e krijimit të këtyre fjalorëve, duhet vështruar në lidhje me gjithë kohën, gjatë së cilës ka kaluar terminologjia shqipe, si në praktikën e saj, në krijimin e bazave teorike, në metodat e punës etj.

Fjalët kyçe: *fjalorët terminologjikë, sisteme terminologjike, bankë të dhëash.*

Veçoritë e pasqyrimit të terminologjive teknike në fjalorët terminologjikë

Në mënyrë të veçantë periudha nga vitet `50 të shek. XX e deri më sot, si fazë e konsoliduar e sistemeve terminologjike, sikurse edhe terminologjive teknike, lidhet me formësimin e gjuhës letrare kombëtare (deri në vitin 1990) dhe të gjuhës standarde (pas vitit 1990 e deri sot). Gjatë kësaj faze janë hartuar një numër i madh fjalorësh terminologjikë teknikë, në të cilët pasqyrohen terminologjitë e njësuara teknike me leksik special të pasur e të gjerë, por edhe kompleks e me probleme të shumta. Kështu, p.sh., duke i vështruar disa shfaqje të dukurisë së sinonimisë (absolute), mund të konstatohet se shprehja e disa koncepteve gjatë zhvillimit të tyre në kohë lidhet me variante të shumta termash njëfjalësh e togfjalësh, një pjesë e të cilëve janë pasqyruar në fjalorë terminologjikë, kurse një pjesë janë zhdukur në kohë. Mund të vërehet se për konceptin "*bosht i motorit"* kanë ekzistuar një varg dysorësh si: *qafë pate – kolodok – bosht motori – bosht*

bërrylor – bërrylor ose për ***"presion"*:***presion – trusni – shtypje – trysni,*kurse sot përdoren *trysni* dhe *presion.*

Duhet theksuar se puna më kryesore në fushën e leksikut terminologjik ka të bëjë me *mbledhjen* e lëndës terminologjike, *përpunimin* e saj dhe pasqyrimin në fjalorët përkatës. Kryerja e kësaj veprimtarie i përket fazës pas viteve `50 të shek. XX, në të cilën gjithë ky proces u realizua në dy drejtime: *së pari* puna filloi mbi baza të institucionalizuara, me qëllim e objektiva të qartë, me krijimin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në vitin 1948 dhe sidomos të Sektorit të Terminologjisë në vitin 1955, duke vënë si qëllim sistemimin, njësimin dhe shqipërimin terminologjive të fushave të ndryshme të dijes. Si rrjedhojë u botuan një varg fjalorësh terminologjikë, si fjalori i botanikës, i matematikës, i kimisë etj. (që nga viti 1963); secila fushë e terminologjisë u ndërtua mi bazën e brumit të gjuhës shqipe dhe gjedheve të saj fjalëformuese; së dyti, u punua edhe mbi baza vetjake, ose në bashkëpunim me qendrat e specializuara në këtë fushë. Kjo veprimtari fillimisht qe më e rrallë, por u intensifikua më vonë, sidomos me fjalorët dygjuhësh (gjuhë e huaj-shqip).

Krijimi i këtyre fjalorëve u karakterizua nga një varg veçorish. Në bazë të tyre u vu *lënda leksikore terminologjike e krijuar nga Rilindësit* tanë, si edhe (të Akademisë së Shkencave dhe të Akademisë Ushtarake), i *teksteve mësimore,* sidomos të shkollës së mesme dhe pjesërisht të universitit në periudhën e mëvonshme. Po kështu duhet nënvizuar se krye të punës për hartimin e tyre fillimisht u vunë *gjuhëtarë të shquar,* si A. Xhuvani, E. Çabej, M. Domi, A. Kostallari etj. Këta fjalorë janë rezultat i *një pune shumëvjeçare* të institucioneve shkencore në bashkëpunim me *dhjetëra specialistë* të fushave të ndryshme të dijes e të teknologjisë, që kanë marrë pjesë në komisionet hartuese nën drejtimin e gjuhëtarëve.

Realisht puna ka nisur *pa përvojën e nevojshme teorike,* por ajo u mbështet mbi bazën e parimeve shkencore e kritereve të huazuara nga terminografia e huaj, dhe, në këtë rast, praktika terminologjike (terminografia) në vendin tonë i ka paraprirë teorisë terminologjike. Po përmendim disa nga parimet e botuara në Fjalorin e parë të serisë terminologjike (1). (Terminologjia e botanikës, 1970, 6-7)

Vlen të theksohet në mënyrë të veçantë se këta fjalorë shërbyen si bazë për ndërmarrjen e një vargu punimesh teorike, të cilat u shfrytëzuan më vonë si mbështetje për përsosjen e mëtejshme të parimeve dhe metodave të punës. Një ndihmë të konsiderueshme dhanë terminologët tanë siL. Dodbiba (Dodbiba, 1963, 183-191), F. Leka (Leka, 1983, 18) etj., të cilët, edhe me veprat e terminologëve pasues si H. Pasho (Pasho, 2005, 168),A. Duro (Duro, 1970, 133), hodhën bazat e terminografisë shqipe. U futën në

qarkullim një varg termash të pasqyruar në fjalorë, sidomos në tekste mësimore, si *baraspeshë* (ekuilibër), *shpërhapje* (difuzion), *tretje* (solucion), *provëz* (epruvetë), *përmasë* (dimension), *rrafsh* (plan), *zhvendosje* (postim), *rrymë* (korrent), *qëndresë* (rezistencë), *qëndrueshmëri* (stabilitet), *mysëti* (konveksitet), *lugëti* (konkavitet) etj.

Puna kryesore u përqendrua në fushat bazë të përgjithshme të dijes botanikës, dhe ato teknike (mek., nd., el.): matematikë (2), kimi (8) (Terminologjia e kimisë, 1970, 12). Ata do të shërbenin si themel për fushat e tjera. Kështu u ndoq tradita e Rilindësve, ku termat e fushave bazë u vunë në qendër të përpunimit dhe pasqyrimit në fjalorë. Kjo veprimtari ballësore në fushën e terminologjisë mund të quhet si "lëvizje gjuhësore në fushën e terminologjisë" (Duro, 2002, 475-480). Puna u zgjerua më tej me: 1. Fjalorët terminologjikë mësimorë dygjuhësh (botuar nga Universiteti Shtetëror i Tiranës); 2. Fjalorët terminologjikë dygjuhësh (botuar nga individë ose nga qendra të tjera); 3. Botimii serisë së fjalorëve terminologjikë (deri më sot 33 fjalorë); 4. Fjalorët e ushtrisë (rreth 13).

Duhet nënvizuar në mënyrë të veçantë se nga vitet `60 të shek. XX deri në ditët e sotme është grumbulluar një lëndë mjaft e pasur dhe e gjerë, dhe, po të përfshijmë këtu edhe fjalorët e hartuar nga qendrat e tjera (Akademia ushtarake, Universitetet), mund të numërohen mbi 1.000.000 njësiP. Hillazi (Hillazi, 2005, 128). Si anë më pozitive të kësaj veprimtarie të gjerë në fushën e terminologjisë mund të theksonim:

- Përpunimi i terminologjive të fushave bazë të dijes dhe pjesërisht të fushave më specifike dhe pasqyrimi në fjalorët përkatës,
- Futja në përdorim e termave të krijuar në tekste mësimore, në vepra shkencore-popullarizuese, në letërsinë artistike, në publicistikë, si: kusht, dukuri, baraspeshë, trysni, përmasë, njehsim etj.
- Shqipja, e ballafaquar në këta fjalorë me gjuhë si frëngjishtja, rusishtja, italishtja, ka treguar se i ka mundësitë për të krijuar, në shkallën më të mundshme, termat me mjetet e veta, e arritur kjo, jo vetëm duke përthithur burimet e brendshme të saj, por duke përdorur, ashtu si edhe gjuhët e tjera, huazime të përzgjedhura me shumë kujdes e me kritere shkencore, sidomos ndërkombëtarizma.

Krahas anëve pozitive u vërehen edhe një varg anësh negative. Në mënyrë të veçantë përpjekja për zëvendësimin e termave të huaj me fjalë të ngritura nga gjuha e përgjithshme shtoi në masë të madhe vargjet sinonimike. Me shtimin e vargjeve sinonimike në nivele të ndryshme, *gjuhë e huaj-shqip* dhe *shqip-shqip*, u rëndua terminologjia me dysorë e trisorë. Megjithatë kjo ndihmoi për të siguruar një shkallë më të lartë motivimi, jepet mundësia

të bëhet përzgjedhje ndërmjet dysorëve, duke ngritur në normë termat që gëzojnë vetitë më të mira, si saktësinë, njëkuptimësinë, qartësinë etj. Proko-Jazexhiu (Proko-Jazexhiu, 2006, 145). Përveç kësaj u futën togfjalësha të shumtë deri në shprehje terminologjike, duke mos përfshirë termat njëfjalësh dhe termat dyfjalësh, të cilët duhet të përbëjnë korpusin real të çdo fjalori terminologjik, ndërsa termat mbidyfjalësh, sidomos ata trifjalësh, duhet të pëfshihen në ta në masë të kufizuar(Duro, 2005, 229-238), si p.sh.: *rrotullim i një pike, punë e forcave tërëndesës* (fj. i mek. teor.), *vlerë efektive e një madhësie periodike, lidhje e një sipërfaqeje të lirë me një paret të ngurtë, moment i një vektori në lidhje me një pikë* (fj. i mat.) etj.

Fjalorët e hartuar deri më sot janë të tipit alfabetik, çka do të thotë, se duke qenë të tillë, japin informacion shumë të kufizuar. Informacioni që merret prej tyre është mjaft i kufizuar, në mënyrë të veçantë për specialistët, meqë aty jepen vetëm termat shqip pa përkufizime, me rreth tre barasvlerës të gjuhës së huaj (ose me katër barasvlerës të gjuhës së huaj). Nga ana tjetër, renditja thjesht alfabetike nuk krijon mundësi për një informacion shkencor më të lidhur dhe më të bashkërenditur. Përveç kësaj, fjalorët janë të mbingarkuar me togfjalësha të shumtë deri me 4-5 gjymtyrë. Jo rrallë, barasvlerësit midis gjuhëve jepen edhe me sinonime, çka vështirëson përcaktimin e saktësisë së termave dhe motivimin e qartësisë së tyre (Pllana, 2016, 14).

Shkëmbimi i përvojës me institucione më të specializuara të vendit tonë me organizmat ndërkombëtare të Evropës në fushën e terminologjisë, kohët e fundit ka krijuar mundësinë për përpunimin dhe paraqitjen e terminologjive në formën e mjeteve të sofistikuara siç janë bazat e të dhënave dhe bankat terminologjike.Me këtë rast vlen të vërehet paraqitja e hierarkizuar e termave siç është paraqitur në Fjalorin e termave themelorë të bujqësisë (Prolo-Jazexhiu, 2009, 152-167., që orienton punën e çdo terminologjie, për t'i vendosur termat sipas një rendi sistematik e hierarkik. Kjo mënyrë lehtëson punën e studimit të njësive terminologjike në rrugë kompjuterike. Në këtë formë arrihet tëë vendosen ato në mënyrë të lexueshme nga kompjuteri. Sistemimi në mënyrë të hierarkizuar dhe paraqitja në kompjuter e lehtëson punën për paraqitjen e këtyre termave në një bankë të dhënash dhe në përfitimin e fjalorëve terminologjikë mbi bazën e një skede të kompjuterizuar. Pikërisht skeda terminologjike në bazë të së cilës qëndrojnë të dhënat mbi termin dhe konceptin, është një nga ato mjete që i nxjerr në pah të metat (sinonimia dhe polisemia) dhe që jep rrugët e zgjidhjes së këtyre problemeve. Në bazë idesë të skedës terminologjike qëndron lidhja e termave dhe e koncepteve dhe vënia e

këtyre të fundit në themel të punës terminologjike (terminografike), duke nxjerrë në pah shkallën e motivueshmërisë së termave. Të gjitha të dhënat paraqiten në skedë në mënyrë të tillë që të jenë të lexueshme nga kompjuteri. Kjo lloj skede me të dhëna të shumta rreth termit dhe konceptit përbën anën themelore të kësaj baze të dhënash dhe krijim të një banke terminologjike të fushës së dhënë.

Ndërtimi i një banke të dhënash model dhe hartimi i fjalorit teknik terminologjik përkatës

Në këtë fillim të mijëvjeçarit të tretë ndërmjet degëve të ndryshme të gjuhësisë një zhvillim të vrullshëm ka marrë edhe gjuhësia kompjuterike ose siç quhet ndryshe inxhinieria e gjuhës. Një ndër metodat e punës është regjistrimi i lëndës terminologjike që qarkullon (në tekste, fjalorë, në ligjërimin praktik me forma kompjuterike, përpunimi i korpusit mbi bazën e një skede të informatizuar. Kjo çon në ndërtimin e bankës terminologjike. Sot në vendin tonë veprimtaria terminologjike për përpunimin e saj dhe pasqyrimin në fjalorë, e kryer mbi bazë kompjuterike, është në fazën e eksperimentimit dhe të modelimit, të cilave u ka paraprirë edhe një punë studimore paraprakeProko-Jazexhiu (Proko-Jazexhiu, 2009, 2009, 152-167).

Parakushte për ndërtimin e bankës së termave

- Pranimi i njësive gjuhësore (leksikore) si njësi të mirëfillta informacioni dhe paraqitja e strukturuar dhe e modeluar dhe përpunimi memetoda kompjuterike në bazë të një programi të caktuar,
- Paraqitja e informacionit leksikor në mënyrë të lidhur dhe të renditur në formën e dëshirueshme nga përdoruesi,
- Hedhja e të dhënave terminologjike në skedë nga *specialisti* i fushës dhe bashkëpunimi i tij me *terminologun* dhe *informatikanin*,
- Krijimi i bazës së të dhënave dhe i bankës terminologjike, duke hedhur të dhënat e skedës në kompjuter.

Puna që kryhet

Identifikimi i mikrofushës *(Poçat)*

- Identifikimi i fushës së gjerë të dijes, brenda së cilës ndodhen nënfushat e mikrofushat,

- Strukturimi i nënfushës dhe identifikimi i mikrofushës modelore që do të përpunohet (5.000 njësi) (→10 njësi model) (shfrytëzimi i KDU-së ose klasifikime të teksteve mësimore nga fusha e elektricitetit).

Paraqitja e një minifushe model

Hierarkia e makrofushës	**Minifusha**
114 Elektriciteti	1. Poçi
↓	↓
114.1 Elektroteknika	2. Poçi me fije metali
↓ ↓	
115 Gjenerimi i rrymës	3. topthi
↓ ↓	
116 Transmetim i rrymës	4. baloni
↓ ↓	
117 Ndriçuesit elektrikë	5. fija e zjarrtë
↓↓	
117.1. Poçat elektrikë	6. filetesa
↓ ↓	
....	7. portollamba
....	↓
....	8. gypi ndriçues
....	↓
117.1.4 Poçi	9. Përcjellësi
.... ↓	
....	10. Kablloja
.... ↓	
....	10.1. veshja
....↓	
....	10.2. fijet
....	↓
125.4 Poçat elektrike	10.3. zemra

4.3. Krijimi i termësit (prej 10 termash) dhe hedhja e të dhënave në skedën terminologjike

SKEDA TERMINOLOGJIKE
(Menyja dhe programi kompjuterik)

1. Numri serial (226)	2. Kodi (117.1)	3. Termi (*Filetesa*)	4. Sinonime (*Fileto, filetesë*)
5. Nënfusha (*Ndriçuesit*)	6. Minifusha (*Poçi*)	7. Përkufizimi: "Pjesë e ndriçuese në forma të ndryshme, sferike, dardhe, ..." (Kryer nga specialisti, redaktuar nga gjuhëtari)	
8. Shpjegimi (Komente) (.....)	9. Përkufizim (Përfundimtar) (.....)	10. Marrëdhënia a (Pjesa/e tëra) (*poçi me fije→poçi*)	
11. Marrëdhënia b (*lloj/gjini*) *poçi-ndriçuesit*	12. Figura (.....)		
13. Anglisht (Light bulb)	14. Italisht (Lampadina)	15. Gjermanisht (Glühbirne)	16. etj.
17. Data e regjistrimit (23 maj 2016)	18. Autori (G. P.)	19. Redaktori (A. D.)	

Hedhja e të dhënave në kompjuter bëhet në bazë të një menyje sipas rendit numerik (1, 2, 3, ... për rastin tonë deri 10.3), të cilat përsëriten veçan për çdo skedë. Në tërësinë e vet kjo përbën edhe Bankën e termave në kompjuter me programin përkatës.

Produktet e përftuara

Paraqitja e Fjalorthit (dalin në mënyrë automatike)
a. Fjalori me rend sistematik dhe alfabetik:
a.1. rend sistematik:*poçi – poçi me fije metali – topthi – baloni – vija e zjarrtë – filetesa – portollamba – gypi ndriçues – përcjellësi – kablloja;*
a.2. rend alfabetik: *baloni-4, fija e zjarrtë-5, filetesa-6, gypi ndriçues-8, kablloja-10, përcjellësi-9, poçi-1, poçi me fije metali-2, portollamba-7, topthi-3.*

Bibliografi

Duro, A.: *"Probleme të përpunimit të terminologjisë dhe të përdorimit të saj në ligjërim",* në Përmbledhjen "Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 20/1", Prishtinë, 2002.

Duro, A.: "Terminologjia si sistem", Tiranë, 2001.

A. Duro, *"Probleme të përpunimit të terminologjisë dhe të përdorimit të saj në ligjërim",* në Përmbledhjen "Seminari Ndërkombëtar për

Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 20/1", Prishtinë, 2002, f. 475-480.

Duro, A.: "*Pasqyrimi i termave me strukturë togfjalëshi në fjalorët terminologjikë të shqipes"*, në Konferencën shkencore "LEKSIKOGRAFIA SHQIPE TRASHËGIMI DHE PERSPEKTIVË', Tiranë, 3 dhjetor 2004, Tiranë, 2005.

Dodbiba, L.: *"Zhvillimi i terminologjisë gjuhësore shqipe nga Rilindja deri sot",* në "Konferenca I e Studimeve Albanologjike", Tiranë, 1963.

"Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore TERMINOLOGJIA E BOTANIKËS 1 (shqip-serbokroatisht-rusisht-frëngjisht", Prishtinë, 1970.

"Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore TERMINOLOGJIA E KIMISË 10 (shqip-serbokroatisht-rusisht-frëngjisht", Prishtinë, 1970.

Hahillazi, P.:*"Leksikologjia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë",* në përmbledhjen Konferenca shkencore, Tiranë, 2005.

Leka, F.: *"Udhëzues për përpunimin e terminologjisë tekniko-shkencore",* Tiranë, 1983.

Pasho, H.: *"Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe nga Rilindja deri në vitet `80 të shek. XX",* Tiranë, 2005.

Pllana, G.: *"Rrafshet e standardizimit në terminologjinë teknike",* në "Java e Albanologjisë", 23 maj 2016, Prishtinë, 2016.

Proko-Jazexhiu, V.: "*Terminologjia e agronomies në rrafshet e lidhjeve sitemore, gjuhësore-konceptore në gjuhën shqipe"*, Tiranë, 2006.

Proko-Jazexhiu, V.: *"Probleme të ruajtjes dhe risjelljes së informacionit shkencor-teknik në terminologji",* në "GJENDJA DHE ZHVILLIMI I TERMINOLOGJISË PROBLEME DHE DETYRA", Konferencë shkencore, ASHSH ASHAK, Tiranë, 2009.